



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 39

Tiranë – E mërkurë, 18 mars 2015

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 11.3.2015	Për lirimin dhe komandimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave..... 1765
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 11.3.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Financave, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICC nr. 20447/MHM S2 Albania sh.p.k. dhe Rapiscan Systems Inc. kundër Republikës së Shqipërisë..... 1765
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 11.3.2015	Për përcaktimin e afateve dhe masave që duhet të merren në lidhje me ankesat për gabimet dhe defektet e botimit dhe publikimit..... 1765
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 215, datë 11.3.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 36, datë 16.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”..... 1766
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 11.3.2015	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, për pagesën e shpenzimeve administrative të arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen nr. ARB/11/24, “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme SA kundër Republikës së Shqipërisë” ..... 1766
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 217, datë 11.3.2015	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për çështjen “Karagiozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (për ankimet nr. 25408/06, 37419/06; 49121/06; 1504/07; 19772/07; 46685/07; 49411/07; 27242/08; 61912/08 dhe 15075/09)..... 1767
Udhëzim i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 11.3.2015	Për mënyrën, format dhe procedurën e dërgimit të tekstit të akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare, si dhe formatin e shkruar në letër dhe formatin elektronik të tyre..... 1769

Udhëzim i ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 6, datë 24.2.2015	Për kriteret e përgjithshme dhe procedurat për marrjen në punë, të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional.....	1770
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 53, datë 26.1.2015	Për skemën e ndihmës shtetërore në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 20.6.2014 “Për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit “Ruzhdi Bizhuta”, Elbasan, dhe financimin e Parkut Olimpik të Tiranës”.....	1781
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 54, datë 26.1.2015	Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga Buxheti i Shtetit në sektorin e sportit.....	1783
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 55, datë 23.2.2015	Autorizim i ndihmës shtetërore për krijimin e “Zonës ekonomike” me statusin “Zonë e lirë” në Spitallë, Durrës.....	1786
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Ded Mhill Logu.....	1788
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Eduart Aliaj.....	1788

**VENDIM****Nr. 211, datë 11.3.2015**

**PËR LIRIMIN DHE KOMANDIMIN NË  
DETYRË TË DREJTORIT TË  
PËRGJITHSHËM TË DOGANAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Znj. Elisa Spiropali lirohet nga detyra e drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

2. Znj. Irena Beqiraj komandohet në detyrën e drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 212, datë 11.3.2015**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR  
PËR MINISTRINË E FINANCAVE, PËR  
PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE  
PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN  
NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT  
NDËRKOMBËTAR ICC NR. 20447/MHM  
S2 ALBANIA SHPK DHE RAPISCAN  
SYSTEMS INC. KUNDËR REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 495 000 (katërqind e nëntëdhjetë

e pesë mijë) eurosh, për kryerjen e pagesave të tarifave të avokatëve në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICC nr. 20447/MHM S2 Albania sh.p.k. dhe Rapiscan Systems Inc. kundër Republikës së Shqipërisë.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontigjencës, miratuar për vitin 2015.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 214, datë 11.3.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE DHE  
MASAVE QË DUHET TË MERREN NË  
LIDHJE ME ANKESAT PËR GABIMET  
DHE DEFEKTET E BOTIMIT DHE  
PUBLIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Qendra e Botimeve Zyrtare pranon ankesat lidhur me gabimet dhe defektet që kanë të bëjnë me botimin dhe publikimin e akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare, si dhe të njoftimeve në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në formë të shtypur ose në formë elektronike.

2. Institucioni që ka nxjerrë aktin ose çdo person i interesuar që identifikon një defekt apo gabim si mospërputhje me origjinalin bën ankesë me shkrim për ndreqjen e tij pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

3. Qendra e Botimeve Zyrtare, në bashkëpunim me institucionin që ka nxjerrë aktin, verifikon ekzistencën e defektit apo gabimit dhe bën ndreqjen, përkatësisht, në Fletoren Zyrtare apo në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare më të parë.

4. Afatet e trajtimit të këtyre ankesave janë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së ankesës. Qendra e Botimeve Zyrtare,



brenda këtij afati, i dërgon përgjigje institucionit apo personit që ka bërë ankesën, duke dhënë informacion edhe për masat e marra.

5. Në rast se gabimi apo defekti identifikohet nga vetë Qendra e Botimeve Zyrtare, ndreqja e gabimit apo defektit bëhet në Fletoren Zyrtare apo në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare më të parë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

#### VENDIM

Nr. 215, datë 11.3.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 36, DATË 16.1.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të pikës 5, të kreut II, të vendimit nr. 752, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës dhe kriterëve për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si dhe të masës së shpërblimit të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Shkronja “b”, e pikës 1, e vendimit nr. 36, datë 16.1.2013, e Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) z. Bledar Dervishaj, përfaqësues i ministrit të Drejtësisë;”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe bordi drejtues i saj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

#### VENDIM

Nr. 216, datë 11.3.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, PËR PAGESËN E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE TË ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR PËR ÇËSHTJEN NR. ARB/11/24, “MAMIDOIL JETOIL GREEK PETROLEUM PRODUCTS SOCIETE ANONYME SA KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, të shtohet fondi 125 040 (njëqind e njëzet e pesë mijë e dyzet) dollarë për të përballuar shpenzimet administrative të arbitrazhit ndërkombëtar për çështjen nr. ARB/11/24, “Mamidoil Jetoil Greek Petroleum Products Societe Anonyme SA, kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konfliktëve në Investimet (ICSID).

2. Fondi prej 125 040 (njëqind e njëzet e pesë mijë e dyzet) dollarësh, i konvertuar në lekë, me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, t’i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontigjencës.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama



## VENDIM

Nr. 217, datë 11.3.2015

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË  
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË  
DREJTAT E NJERIUT, DATË 8.4.2014,  
PËR ÇËSHTJEN “KARAGJOZI DHE TË  
TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR  
ANKIMET NR. 25408/06, 37419/06;  
49121/06; 1504/07; 19772/07; 46685/07;  
49411/07; 27242/08; 61912/08 DHE  
15075/09)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për çështjen “Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimet: nr. 25408/06 (Karagjozi dhe të tjerë); nr. 49121/06 (Koco); nr. 19772/07 (Shehu); nr. 46685/07 (Dovrani dhe Dume); nr. 49411/07 (Sallabanda dhe Hoxha); nr. 27242/08 (Goga dhe të tjerë); nr. 61912/08 (Tartari) dhe nr. 15075/09 (Okaj), sipas listës së ankuesve në shtojcën 1, dhe shumat e përcaktuara në shtojcat 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij vendimi dhe që janë pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për secilën çështje.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve: Karagjozi dhe të tjerë (nr. 25408/06); Koco (nr. 49121/06); Shehu (nr. 19772/07); Dovrani dhe Dume (nr. 46685/07); Sallabanda dhe Hoxha (nr. 49411/07); Goga dhe të tjerë (nr. 27242/08); Tartari (nr. 61912/08) dhe Okaj (nr. 15075/09), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i Ministrisë së Financave, brenda një afati 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, AKKP-ja dhe Ministria e Financave që, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për çështjen “Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (ankimet nr. 25408/06, nr. 37419/06; nr. 49121/06; nr. 1504/07; nr. 19772/07; nr. 46685/07; nr. 49411/07; nr. 27242/08; nr. 61912/08 dhe nr. 15075/09), është bërë përfundimtar, të ekzekutojnë, në favor të ankimit 37419/06 (Budini), vendimin nr. 43, datë 28.3.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Mat, për kompensimin e sipërfaqes 3 178 m<sup>2</sup> me obligacione.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe AKKP-ja që, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për çështjen “Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (ankimit nr. 25408/06, nr. 37419/06; nr. 49121/06; nr. 1504/07; nr. 19772/07; nr. 46685/07; nr. 49411/07; nr. 27242/08; nr. 61912/08 dhe nr. 15075/09) është bërë përfundimtar, të ekzekutojnë, në favor të ankimit nr. 1504/07 (Hajnaj), vendimin nr. 1016, datë 28.12.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të ndryshuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 3847, datë 15.7.2004.

8. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Financave, në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”.



9. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

## SHTOJCA 1 – LISTA E APLIKANTËVE

Nr.	Emri dhe numri i aplikimit	Emri i aplikantit(ve) (viti i lindjes)	Shteti i vendbanimit	Përfaqësuar nga	Data e prezantimit
1.	Karagiozi dhe të tjerë nr. 25408/06	Pëllumb Karagiozi (1936) Halim Karagiozi (1941) Sibo Karagiozi (1933) Sezar Babameto (1928) Eçerem Babameto (1929) Aila Babameto (1939) Bardha Kokona (1946) Genti Kokona (1983) Redrina Kokona (1976) Briseida Kokona (1954) Endri Shuke (1984) Tefik Kokona (1942) Arben Dedei (1967)	Shqipëri	S. Puto, avokat	13 qershor 2006
2.	Budini, nr. 37419/06	Bajram Budini (1942)	Shqipëri	V. Muzina, avokat	31 gusht 2006
3.	Koco, nr. 49121/06	Gjenci Koco (1936)	Shqipëri	S. Puto, avokat	1 dhjetor 2006
4.	Hajnaj, nr. 1504/07	Veliko Hajnaj (1963)	Shqipëri	T. Jorgji, Z. Gani, D. Kruja, avokat	25 dhjetor 2006
5.	Shehu, nr. 19772/07	Agim Shehu (1952) Petrit Shehu (1957) Bardhyl Shehu (1937) Sanie Bakalli, née Shehu (1934)	Shqipëri	S. Puto, avokat	3 maj 2007
6.	Dvorani dhe Dume, nr.46685/07	Valter Dvorani (1952) Shpetim Dvorani (1938) Pranvera Dvorani (1954) Diana Dvorani (1958) Gurie Dvorani (1925) Svjetllana Dume (1949) Besa Dume (1952) Fatbardha Dume (1954)	Shqipëri	S. Puto, avokat	9 tetor 2007
7.	Sallabanda dhe Hoxha, nr. 49411/07	Virgjil Sallabanda (1933) Meri Hoxha (1937) Afërdita Sallabanda (1946)	Shqipëri	A. Tartari, avokat	25 tetor 2007
8.	Goga dhe të tjerë, nr. 27242/08	Çezar Goga (1955) Kristaq Goga (1917) Kostandina Goga (1925) Aleksander Goga (1948) Ilira Gjika, née Goga (1955) Olimbia Goga (1931) Stavri Paço (1952) Mirsa Paço (1983) Danila Paço (1990) Sofia Goga (1916) Afërdita Jani, née Goga (1948) Ansi Kromidha, née Goga (1938) Dorian Goga (1973)	Shqipëri dhe Itali	S. Puto, avokat	3 qershor 2008



		Sonila Serdani, née Goga (1977) Viktor Noçka (1935) Albert Noçka (1952)			
9.	Tartari, nr. 61912/08	Fatos Tartari (1938)	Shqipëri	A. Tartari, avokat	24 nëntor 2008
10.	Okaj, nr. 15075/09	Gazmend Okaj (1961) Fadil Okaj (1934) Vjollca Okaj (1958) Ardiana Okaj (1965)	Shqipëri	B. Muslija, avokat	7 mars 2009

## SHTOJCA 2 – DËMI MONETAR DHE JOMONETAR

Nr.	Emri dhe nr. i aplikimit	Dëmi monetar dhe jomonetar
1.	Karagozi dhe të tjerë nr. 25408/06	1,092,600 euro (një milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind euro).
2.	Budini, nr. 37419/06	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
3.	Koco nr. 49121/06	750,500 euro (shtatëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind euro).
4.	Hajnaj, nr. 1504/07	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
5.	Shehu, nr. 19772/07	205,000 euro (dyqind e pesë mijë euro, për sa ka të bëjë me pjesën e aplikantit).
6.	Dvorani dhe Dume, nr. 46685/07	54,800 euro (pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind euro).
7.	Sallabanda dhe Hoxha, nr. 49411/07	3,589,600 euro (tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë e gjashtëqind euro).
8.	Goga dhe të tjerë, nr. 27242/08	1,120,000 euro (një milion e njëqind e njëzet mijë euro).
9.	Tartari, nr. 61912/08	521,000 euro (pesëqind e njëzet e një mijë euro).
10.	Okaj, nr. 15075/09	820,500 euro (tetëqind e njëzet mijë e pesëqind euro).

## SHTOJCA 3 – KOSTOT DHE SHPENZIMET

Nr.	Emri dhe nr. i aplikantit	Kostot dhe shpenzimet
1.	Karagozi dhe të tjerë nr. 25408/06	1,650 euro (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro).
2.	Budini, nr. 37419/06	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
3.	Koco, nr. 49121/06	1,450 euro (një mijë e katërqind e pesëdhjetë euro).
4.	Hajnaj, nr. 1504/07	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
5.	Shehu, nr. 19772/07	1,550 euro (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë euro).
6.	Dvorani dhe Dume, nr. 46685/07	1,650 euro (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro).
7.	Sallabanda dhe Hoxha, nr. 49411/07	400 euro (katërqind euro).
8.	Goga dhe të tjerë, nr. 27 242/08	1,100 euro (një mijë e njëqind euro).
9.	Tartari, nr. 61912/08	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
10.	Okaj, nr. 15075/09	1,200 euro (një mijë e dyqind euro).

## UDHËZIM

Nr. 2, datë 11.3.2015

**PËR MËNYRËN, FORMAT DHE  
PROCEDURËN E DËRGIMIT TË  
TEKSTIT TË AKTEVE TË BOTUESHME  
NË FLETORËN ZYRTARE, SI DHE  
FORMATIN E SHKRUAR NË LETËR  
DHE FORMATIN ELEKTRONIK TË  
TYRE**

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të pikës 12, të nenit 8, të ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

## UDHËZON:

1. Teksti i akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare i dërgohet Qendrës së Botimeve Zyrtare, në formatin e shkruar në letër dhe në formatin elektronik, nga institucionet shtetërore përkatëse, që kanë miratuar aktin në të njëjtën ditë, por, në çdo rast, jo më vonë se afatet e parashikuara në nenin 8, ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

2. Aktet e botueshme publikohen në Fletoren Zyrtare vetëm atëherë kur versioni përfundimtar, në origjinal, i aktit, është nënshkruar nga organi që e ka nxjerrë atë dhe me kërkesën e tij.

3. Akti i dërguar në formë elektronike duhet



të jetë në formatin Word dhe duhet të dërgohet përmes postës elektronike zyrtare ose në CD, bashkëlidhur aktit në formë shkresore.

4. Materiali duhet të dërgohet pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare sipas standardit të gjuhës shqipe. Këto standarde duhen zbatuar edhe për dokumentet bashkëlidhur aktit.

5. Institucioni shtetëror, që dërgon aktin e botueshëm, nëse është e mundur, kujdeset që formati elektronik të nënshkruhet elektronikisht, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Të dyja formatet kanë vlerë të njëjtë juridike. Në rast mospërputhjeje të formateve, Qendra e Botimeve Zyrtare i kërkon institucionit të konfirmojë përmbajtjen e saktë të aktit të botueshëm dhe, vetëm pas përgjigjes zyrtare të institucionit dërgues, vijon me botimin e aktit.

7. Marrëveshjet ndërkombëtare botohen, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën angleze, në rast se janë nënshkruar në këtë gjuhë. Botimi bëhet në të njëjtën faqe, të ndarë në dy kolona, ku secilit nen në gjuhën shqipe i korrespondon neni në gjuhën angleze dhe, në pjesën e fundit të tyre, vendoset data e nënshkrimit të tyre.

8. Ngarkohen Qendra e Botimeve Zyrtare dhe të gjitha institucionet shtetërore, që botojnë akte në Fletoren Zyrtare, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

#### UDHËZIM

Nr. 6, datë 24.2.2015

### **PËR KRITERET E PËRGJITHSHME DHE PROCEDURAT PËR MARRJEN NË PUNË, TË PERSONELIT TË MËSIMDHËNIES TEORIKE DHE PRAKTIKE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 26, 54 dhe 60 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neneve 22, pika “d” dhe 23, pika “c” e ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002

“Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

#### UDHËZIJMË:

I. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë personeli i mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional

1. Aplikanti për mësues i kulturës së përgjithshme në institucionet publike të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

a) të ketë një diplomë nga një institucion i arsimit të lartë, për një nga fushat lëndore që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës së përgjithshme të institucionit dhe të ketë një diplomë të nivelit të dytë të studimeve universitare në fushën e edukimit;

b) të ketë kaluar provimin e shtetit dhe të ketë marrë licencën si mësues;

c) të mos ketë masa administrative dhe penale në fuqi.

2. Aplikanti për mësues i kulturës profesionale (teori profesionale) në institucionet publike të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

a) të ketë minimalisht një diplomë të nivelit Master profesional (ose të barasvlershme me të), për një nga profesionet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të institucionit;

b) të mos ketë masa administrative dhe penale në fuqi.

3. Aplikanti për mësues/specialist (instruktur) i formimit praktik në institucionet publike të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

a) të ketë një diplomë nga një institucion i arsimit të lartë, në një nga profesionet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të institucionit;

b) të ketë jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në profilin teknik të aplikimit;

c) të mos ketë masa administrative dhe penale në fuqi;

ç) përjashtimisht kur pas 2 shpalljesh konkursi radhazi nuk ka asnjë aplikant me arsim të lartë, do të pranohen aplikantë me arsim të mesëm profesional sipas profilit teknik të vendit vakant.

4. Aplikanti për specialist (mësimdhënës) i formimit profesional, në qendrat publike të formimit profesional duhet të përmbushë këto kritere:





a) të ketë një diplomë të arsimit të lartë, të lidhur me profilin e instruktorit të formimit profesional;

b) të ketë jo më pak se 2 vjet eksperiencë pune në profilin teknik të aplikimit;

c) të mos ketë masa administrative dhe penale në fuqi.

II. Procedurat për marrjen në punë të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional

1. Kur krijohet një vend i lirë pune në personelin e mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të AFP-së, drejtori i institucionit brenda 5 ditëve pune, shpall njoftimin: në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në mjediset e jashtme të institucionit ofrues të AFP-së, në faqen e tij elektronike zyrtare (nëse ka), dhe në portalin e Arsimit dhe Formimit Profesional.

Për rastet e mësuesve të kulturës së përgjithshme, njoftohet DAR/ZA përkatëse, nëse ka të tillë nga lista e pritjes.

2. Krijimi i vendit të lirë vlerësohet duke marrë në konsideratë:

a) largimin nga puna të një anëtari të personelit;

b) kriteret që lidhen me normat për ngarkesën mësimore/edukative dhe numrin e nxënësve në institucion;

c) për shpalljen e vendit vakant, drejtuesi i institucionit merr më parë miratimin nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

3. Shpallja përmban afatin e aplikimit, si edhe kriteret e veçanta për aplikantin e kërkuar.

4. Dosja e aplikantit përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, ku përfshihen:

a) jetëshkrimi dhe kopjet e dokumenteve mbështetëse, sipas modelit në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) të dhënat e aplikuesit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

c) raporti mjeko-ligjor;

ç) deklarata e aplikuesit nëse ndaj tij nuk janë marrë masa disiplinore në punësimet e mëparshme, dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se 3 muaj para datës së aplikimit.

5. Dokumentet e aplikimit, përcaktuar në

pikën 4, protokollohet pranë drejtorisë së institucionit publik ofrues të AFP-së.

6. Afati i dorëzimit të dokumentacionit duhet të jetë por jo më pak se 15 ditë kalendarike nga data e shpalljes së vendit të lirë. Ai shënohet në njoftimin e shpalljes së vendit të lirë.

7. Nëse pas përfundimit të afatit, nuk paraqitet asnjë aplikant, afati i aplikimit shtyhet për 15 ditë kalendarike.

8. Me aplikantin që shpallet fitues dhe punësohet në atë institucion, lidhet kontratë pune me kohëzgjatje të pacaktuar.

III. Komisioni i vlerësimit

1. Në institucionet publike të arsimit profesional, komisioni i vlerësimit përbëhet nga:

a) një përfaqësues i biznesit, anëtar i bordit të institucionit publik;

b) mësuesi i kulturës profesionale me përvojën më të gjatë në institucion;

c) kryetari i këshillit të prindërve të nxënësve;

ç) një mësues, anëtar i bordit të institucionit. Për mësuesit e kulturës së përgjithshme, anëtari i bordit duhet të jetë përfaqësuesi i DAR/ZA;

d) një mësues, i zgjedhur me short nga personeli mësimdhënës.

2. Komisioni i vlerësimit në institucionet e formimit profesional përbëhet nga:

a) një përfaqësues i biznesit, anëtar i bordit të institucionit publik;

b) specialisti me përvojën më të gjatë në institucionin ofrues të FP-së;

c) një specialist i zgjedhur me short nga personeli mësimdhënës.

3. Komisioni i vlerësimit në institucionet e arsimit dhe formimit profesional drejtohet nga përfaqësuesi i biznesit, anëtar i bordit.

4. Komisioni mbledhet në mjediset e institucionit, jo më vonë se 5 ditë pune pas afatit të dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit dhe kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij.

5. Fillimisht anëtarët e komisionit duhet të nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit dhe etikës profesionale, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Anëtari i komisionit, që mungon ose është në konflikt interesi, zëvendësohet sipas strukturës së përfaqësimit.

7. Vendimet e komisionit merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

8. Komisioni kryen këto detyra:



a) shqyrton, rregullsinë e dokumentacionit të aplikimit dhe liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë;

b) aplikantët me parregullsi, njoftohen me shkrim për mangësitë në dokumentacion;

c) vlerëson të dhënat e aplikantëve të pranuar, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

ç) vlerëson nëpërmjet intervistës secilin aplikant, me pikë nga 1 në 10;

d) vlerëson nëpërmjet vëzhgimit në dy orë mësimore, secilin prej aplikant për mësues, (ose dy seanca instruktimi të aplikantit për instruktor), nëpërmjet të paktën tre anëtarëve të komisionit, me pikë nga 1 në 20);

dh) në rastet kur anëtarët e komisionit nuk kanë profilin përkatës, vëzhgimi i orëve mësimore i caktohet një mësuesi (ose një instruktori të profilit përkatës).

9. Në përfundim të vlerësimit, komisioni mbledh pikët e secilit aplikant, bën renditjen e tyre dhe shpall brenda ditës në një vend publik në institucion, renditjen e aplikantëve.

10. Kundër rezultatit të shpalljes së pikëve, bëhet ankim brenda 5 ditëve pune nga dita e shpalljes, pranë drejtorit të institucionit publik të AFP-së.

11. Komisioni shqyrton ankimet brenda 3 ditëve pune.

12. Kryetari i komisionit i dorëzon drejtorit të institucionit dosjet e aplikimit dhe vlerësimet me pikë të kandidatëve.

13. Drejtori i institucionit për zgjedh njërin prej dy kandidatëve, me numrin më të madh të pikëve dhe bën emërimin e tij.

14. Kur ka më shumë se dy aplikantë me numër të njëjtë pikësh, zgjidhet ai që ka më shumë pikë në vëzhgimin e orëve mësimore, ose seancave të instruktimit.

IV. Procedura për marrjen në punë të mësuesve dhe instruktorëve me kohë të pjesshme në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional

1. Drejtori i institucionit publik shpall njoftimin: në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në një vend të dukshëm

në mjediset e jashtme të institucionit publik ofrues të AFP-së, në faqen e tij elektronike zyrtare, nëse ka, dhe në portalin elektronik të Arsimit dhe Formimit Profesional, për 10 ditë kalendarike.

2. Pas përfundimit të afatit, drejtori i institucionit shpall renditjen e kandidatëve në përputhje me kriteret e përcaktuara respektivisht në kreun I dhe në kualifikimet dhe arrijtjet në mësimdhënie.

3. Me kandidatin e renditur në vend të parë, nënshkruhet kontratë pune me afat të caktuar.

V. Procedura e lirimimit nga puna të personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike në institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional

1. Përfundimi i marrëdhënies së punës së personelit të mësimdhënies teorike dhe praktike, bëhet kur:

a) përmbushen kriteret e daljes në pension;

b) jep dorëheqjen;

c) deklarohet i paaftë për përmbushjen e detyrave;

ç) nuk përmbush kriteret e parashikuara në pikën I, të këtij udhëzimi;

d) merret masa disiplinore e largimit nga puna;

dh) kryen shkelje të Kodit të Punës, kontratës kolektive ose individuale të punës;

e) institucioni reformohet, mbyllet, ose shkurtohet vendi i punës;

ë) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës.

2. Largimi nga detyra bëhet me vendim të drejtorit të shkollës, duke zbatuar dispozitat e Kodit të Punës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES  
SOCIALE DHE RINISË  
**Erion Veliaj**

MINISTRI I ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
**Lindita Nikolla**



## SHTOJCA 1

## JETËSHKRIM

I. EMRI MBIEMRI

II. DATËLINDJA

III. TELEFONI

IV. ARSIMI

V. GRADAT, TITUJT

VI. KUALIFIKIMI

VII. CERTIFIKATA

VIII. PUNËSIMI

IX. BOTIMET

X. PROJEKTE

XI. PROVIMET KOMBËTARE

## UDHËZIME

## 1. ARSIMI

Diploma (diplomat) e shkollës së lartë për arsimin.

## 2. GRADAT, TITUJT

Master, doktor, asistent profesor, profesor (në arsim).

## 3. KUALIFIKIMI

Kategoria e kualifikimit si mësues dhe vlerësimi përkatës (nëse ka pasur vlerësim)

## 4. NOTA MESATARE

Nota mesatare në shkollën lartë (e rrumbullakosur në numër të plotë)

## 5. CERTIFIKATA

a) Shënohen vetëm certifikatat për zotërimin e njohurive ose shprehive të caktuara ose marrjen e krediteve.

b) Certifikata janë:

- Zotërimi i njohurive të caktuara në arsim.
- Zotërimi i një gjuhe të huaj.
- Zotërimi i një programi të caktuar kompjuterik.
- Të tjera.

c) Shënohet vendi dhe viti i marrjes së certifikatës.

d) Nuk shënohen pjesëmarrjet në seminare.

## 6. PUNËSIMI

Renditen, njëra pas tjetrës, të gjitha punësimet sipas rendit kronologjik, duke filluar nga më i fundit.

## 7. BOTIMET

a) Për çdo botim shkruhet emri, mbiemri i bashkautorëve (nëse ka), titulli i botimit, institucioni botues dhe viti i botimit.

b) Botimet ndahen në libra shkencorë dhe artikuj.

## TË TJERA

- Për kategorinë e kualifikimit si mësues, diplomat e shkollës së lartë dhe lista e notave të shkollës së lartë, paraqiten fotokopje të noterizuara të tyre.

- Për gradat e titujt shkencorë paraqiten fotokopje të tyre.

- Për certifikatat paraqiten fotokopjet e tyre.

- Për librat paraqitet fotokopja e faqes së parë.

- Për shkrimet paraqiten fotokopje e faqes së parë.

- Për kumtesat paraqitet fotokopja e faqes së parë.

- Për provimet kombëtare paraqiten dëshmi të firmosura nga DAR/ZA-ja përkatëse.

## SHTOJCA 2:

## TABELA E TË DHËNAVE PËR APLIKUESIN

Emri mbiemri \_\_\_\_\_

Aplikuesi shënon brenda kllapave krahas rubrikës përkatëse:

- “Po” ose “Jo”, kur kërkohet përgjigje e tillë.

- Numrin përkatës, kur kërkohet numri.

I	CERTIFIKATA
1	Certifikata (numri)
2	Numri i krediteve të fituara ( )
3	Vlerësimi në provimin e kualifikimit: “Shkëlqyeshëm” (Po/Jo) “Shumë mirë” (Po/Jo) “Mirë” (Po/Jo) “Mjaftueshëm” (Po/Jo) “Dobët” (Po/Jo)
II	LIBRA
1	Autor në tekstet shkollore (numri)
2	Autor në tekstet për mësuesit (numri)
3	Autor libri për mësimdhënien (numri)



4	Autor libri për çështje të tjera arsimore (numri)
III	SHKRIME
1	Shkrime për mësimdhënien (numri)
2	Shkrime për çështje të tjera arsimore (numri)
IV	KUMTESA
1	Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin (numri)
2	Kumtesa në takime kombëtare për arsimin (numri i tyre)
V	GJUHA E HUAJ E MBROJTUR
1	Gjuha angleze ( )
2	Gjuhë e huaj tjetër e vendeve të BE-së (numri i gjuhëve)
VI	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TË MBROJTURA)
1	Microsoft Word ( )
2	Përdorimi i internetit ( )
3	Excel ( )
4	Power Point ( )
VII	NOTAT
	Nota mesatare në shkollën lartë e rrumbullakosur në numër të plotë ( )
VIII	PROVIMET KOMBËTARE
1	Administrator në provimet kombëtare (numri i herëve)
2	Hartues i testeve në provimet kombëtare (numri i herëve)
3	Vlerësues i përgjigjeve të nxënësve në provimet kombëtare (numri i herëve)
IX	PROJEKTE (numri i tyre)

Dëshmoj se i kam kuptuar udhëzimet për plotësimin e shtojcës 2 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Firma

Data

### SHTOJCA 3: UDHËZIM PËR KOMISIONIN E VLERËSIMIT

#### 1. Pranimi ose mospranimi i një aplikimi

a) Komisioni nuk pranon aplikimet në të cilat mungon njëra nga këto të dhëna:

- kopja e noterizuar për kategorinë e kualifikimit si mësues, e diplomës së shkollës së lartë dhe e licencës (nëse ka);

- kopjet e noterizuara të listës së notave të shkollës së lartë.

b) Komisioni pranon aplikimet për çdo mungesë tjetër, por shënon me zero pikët për mungesat përkatëse.

#### 2. Pikët e intervistës

Mblidhen pikët e secilit anëtar, shuma pjesëtohet me numrin e anëtarëve të komisionit dhe rezultati rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

#### 3. Pikët e vëzhgimit të orëve mësimore

a) Kur vëzhgohet vetëm një orë mësimore, mblidhen pikët e secilit anëtar, shuma pjesëtohet

me numrin e anëtarëve të komisionit dhe rezultati rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

b) Kur vëzhgohen dy orë mësimore, mblidhen të gjitha pikët e anëtarëve për të dyja vëzhgimet dhe shuma pjesëtohet me numrin total të anëtarëve që kanë vëzhguar.

c) Rezultati rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

#### 4. Pikët e një aplikuesi

a) Për të plotësuar pikët e një aplikuesi, komisioni bazohet te jetëshkrimi i tij.

b) Në shtyllën “T” vendosen pikët që i takojnë çdo rubrike.

#### c) Rubrikat janë:

Lloji i parë. Pikët e shtyllës “T” vendosen drejtpërdrejt te shtylla përkatëse e aplikantit si: gjuha angleze, master e disa të tjera. Këto janë për përgjigjet “Po”.

Lloji i dytë. Pikët e shtyllës “T” shumëzohen me numrin përkatës te shtojca 2 e aplikantit.



TABELA E PIKËVE TË NJË APLIKANTI

I		T	Aplikanti
1	Certifikata (2)	5	10
2	Numri i krediteve të fituara (3)	10	30
3	Vlerësimi në provimin e kualifikimit: “Shkëlqyeshëm” (Jo) “Shumë mirë” (Po) “Mirë”, (Jo) “Mjaftueshëm”, (Jo) “Dobët” (Jo)	10 8 6 2 0	8
II	LIBRA		
1	Autor në tekstet shkollore (0)	10	0
2	Autor në tekstet për mësuesit (0)	10	0
3	Autor libri për mësimdhënien (0)	10	0
4	Autor libri për çështje të tjera arsimore (0)	8	0
III	SHKRIME		
1	Shkrime për mësimdhënien (2)	5	10
2	Shkrime për çështje të tjera arsimore (0)	3	0
IV	KUMTESA		
1	Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin (0)	10	0
2	Kumtesa në takime kombëtare për arsimin (0)	8	0
V	GJUHA E HUAJ E MBROJTUR		
1	Gjuha angleze (Po)	5	5
2	Gjuhë e huaj tjetër e vendeve të BE-së (Jo)	3	0
VI	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TË MBROJTURA)		
1	Microsoft Word (Po)	3	3
2	Përdorimi i internetit (Po)	3	3
3	Excel (Jo)	3	0
4	Power Point (Po)	3	3
VII	NOTAT		
	Nota mesatare në shkollën lartë e rumbullakosur në numër të plotë		7
VIII	PROVIMET KOMBËTARE		
1	Administrator në provimet kombëtare (0)	2	0
2	Hartues i testeve në provimet kombëtare (0)	6	0
3	Vlerësues i përgjigjeve të nxënësve në provimet kombëtare (0)	6	0
IX	PROJEKTE (2)	4	8
X	Intervista		8
XI	Vëzhgime		15
	<b>SHUMA</b>		

Shpallet tabela e pikëve totale për të gjithë aplikantët.

Emri i aplikantit	Pikët totale
A	
B	
C	

Firmat e anëtarëve të komisionit



## SHTOJCA 2

## JETËSHKRIM

I. EMRI MBIEMRI

II. DATËLINDJA

III. TELEFONI

IV. ARSIMI

V. GRADAT, TITUJT

VI. KUALIFIKIMI

VII. CERTIFIKATA

VIII. PUNËSIMI

IX. BOTIMET

X. PROJEKTE

XI. PROVIMET KOMBËTARE

## UDHËZIME

## PLOTËSIMI I CURRICULUM VITAE

## 1. ARSIMI

Diploma (diplomat) e shkollës së lartë për arsimin.

## 2. GRADAT, TITUJT

Master, doktor, asistent profesor, profesor (në arsim)

## 3. KUALIFIKIMI

Kategoria e kualifikimit si mësues dhe vlerësimi përkatës (nëse ka pasur vlerësim)

## 4. NOTA MESATARE

Nota mesatare në shkollën lartë (e rrumbullakosur në numër të plotë)

## 5. CERTIFIKATA

a) Certifikatat për gjuhët e huaja.

b) Certifikatat për pjesëmarrje në trajnime, të marra brenda ose jashtë vendit, për aspekte të biznesit, drejtimin e shkollave/qendrave profesionale, aspekte të mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale, zhvillimin e praktikave profesionale dhe të tjera që lidhen me detyrën e nëndrejtorit të një institucioni publik të AFP-së.

c) Certifikatat për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit si: Microsoft Word, përdorimi i internetit, Excel, Power Point etj.

## 6. PUNËSIMI

Renditen, njëra pas tjetrës, të gjitha punësimet sipas rendit kronologjik, duke filluar nga më e fundit.

## 7. BOTIMET

a) Për çdo botim shkruhet emri, mbiemri i bashkautorëve (nëse ka), titulli i botimit, institucioni botues dhe viti i botimit.

b) Botimet ndahen në libra për sistemin e AFP ose biznesin dhe artikuj për AFP-në ose biznesin.

## 8. TË TJERA

- Për kategorinë e kualifikimit si mësues, diplomat e shkollës së lartë dhe lista e notave të shkollës së lartë, paraqiten fotokopje të noterizuara të tyre.

- Për gradat e titujt shkencorë paraqiten fotokopje të tyre.

- Për certifikatat paraqiten fotokopjet e tyre.

- Për librat paraqitet fotokopja e faqes së parë.

- Për shkrimet paraqitet fotokopje e faqes së parë.

- Për kumtesat paraqitet fotokopja e faqes së parë.

- Për provimet kombëtare paraqiten dëshmi të firmosura nga DAR/ZA-ja përkatëse.

## SHTOJCA 2:

## TABELA E TË DHËNAVE PËR APLIKUESIN

Emri mbiemri \_\_\_\_\_

Aplikuesi shënon brenda kllapave krahas rubrikës përkatëse:

- “Po” ose “Jo”, kur kërkohet përgjigje e tillë.

- Numrin përkatës, kur kërkohet numri.

I	CERTIFIKATA
1	Certifikata (numri )
2	Numri i krediteve të fituara ( )
3	Vlerësimi në provimin e kualifikimit: “Shkëlqyeshëm” (Po/Jo) “Shumë mirë” (Po/Jo) “Mirë” (Po/Jo) “Mjaftueshëm” (Po/Jo) “Dobët” (Po/Jo)
II	LIBRA
1	Autor në tekstet shkollore (numri)
2	Autor në tekstet për mësuesit (numri)



3	Autor libri për mësimdhënien (numri)
4	Autor libri për çështje të tjera arsimore (numri)
III	SHKRIME
1	Shkrime për mësimdhënien (numri)
2	Shkrime për çështje të tjera arsimore (numri)
IV	KUMTESA
1	Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin (numri)
2	Kumtesa në takime kombëtare për arsimin (numri i tyre)
V	GJUHA E HUAJ E MBROJTUR
1	Gjuha angleze ( )
2	Gjuhë e huaj tjetër e vendeve të BE-së (numri i gjuhëve)
VI	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TË MBROJTURA)
1	Microsoft Word ( )
2	Përdorimi i internetit ( )
3	Excel ( )
4	Power Point ( )
VII	NOTAT
	Nota mesatare në shkollën lartë e rrumbullakosur në numër të plotë ( )
VIII	PROVIMET KOMBËTARE
1	Administrator në provimet kombëtare (numri i herëve)
2	Hartues i testeve në provimet kombëtare (numri i herëve)
3	Vlerësues i përgjigjeve të nxënësve në provimet kombëtare (numri i herëve)
IX	PROJEKTE (numri i tyre)

Dëshmoj se i kam kuptuar udhëzimet për plotësimin e shtojcës 2 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Firma

Data

### SHTOJCA 3: UDHËZIM PËR KOMISIONIN E VLERËSIMIT

#### 1. Pranimi ose mospranimi i një aplikimi

a) Komisioni nuk pranon aplikimet në të cilat mungon njëra nga këto të dhëna:

- kopja e noterizuar për kategorinë e kualifikimit si mësues, e diplomës së shkollës së lartë dhe e licencës (nëse e ka);

- kopjet e noterizuara të listës së notave të shkollës së lartë.

b) Komisioni pranon aplikimet për çdo mungesë tjetër, por shënon me zero pikët për mungesat përkatëse.

#### 2. Pikët e intervistës

Mblidhen pikët e secilit anëtar, shuma pjesëtohet me numrin e anëtarëve të komisionit dhe rezultati rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

#### 3. Pikët e vëzhgimit të orëve mësimore

a) Kur vëzhgohet vetëm një orë mësimore, mblidhen pikët e secilit anëtar, shuma pjesëtohet

me numrin e anëtarëve të komisionit dhe rezultati rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

b) Kur vëzhgohen dy orë mësimore, mblidhen të gjitha pikët e anëtarëve për të dyja vëzhgimet dhe shuma pjesëtohet me numrin total të anëtarëve që kanë vëzhguar.

c) Rezultati rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

#### 4. Pikët e një aplikuesi

a) Për të plotësuar pikët e një aplikuesi, komisioni bazohet te jetëshkrimi i tij.

b) Në shtyllën “T” vendosen pikët që i takojnë çdo rubrike.

#### c) Rubrikat janë:

Lloji i parë Pikët e shtyllës “T” vendosen drejtpërdrejt te shtylla përkatëse e aplikantit si: gjuha angleze, master e disa të tjera. Këto janë për përgjigjet “Po”.

Lloji i dytë. Pikët e shtyllës “T” shumëzohen me numrin përkatës te shtojca 2 e aplikantit.



TABELA E PIKËVE TË NJË APLIKANTIT

I		T	Aplikanti
1	Certifikata (2)	5	10
2	Numri i krediteve të fituara (3)	10	30
3	Vlerësimi në provimin e kualifikimit: “Shkëlqyeshëm” (Jo) “Shumë mirë” (Po) “Mirë” (Jo) “Mjaftueshëm” (Jo) “Dobët” (Jo)	10 8 6 2 0	8
II	LIBRA		
1	Autor në tekstet shkollore (0)	10	0
2	Autor në tekstet për mësuesit (0)	10	0
3	Autor libri për mësimdhënien (0)	10	0
4	Autor libri për çështje të tjera arsimore (0)	8	0
III	SHKRIME		
1	Shkrime për mësimdhënien (2)	5	10
2	Shkrime për çështje të tjera arsimore (0)	3	0
IV	KUMTESA		
1	Kumtesa në takime ndërkombëtare për arsimin (0)	10	0
2	Kumtesa në takime kombëtare për arsimin (0)	8	0
V	GJUHA E HUAJ E MBROJTUR		
1	Gjuha angleze (Po)	5	5
2	Gjuhë e huaj tjetër e vendeve të BE-së (Jo)	3	0
VI	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TË MBROJTURA)		
1	Microsoft Word (Po)	3	3
2	Përdorimi i internetit (Po)	3	3
3	Excel (Jo)	3	0
4	Power Point (Po)	3	3
VII	NOTAT		
	Nota mesatare në shkollën lartë e rumbullakosur në numër të plotë		7
VIII	PROVIMET KOMBËTARE		
1	Administrator në provimet kombëtare (0)	2	0
2	Hartues i testeve në provimet kombëtare (0)	6	0
3	Vlerësues i përgjigjeve të nxënësve në provimet kombëtare (0)	6	0
IX	PROJEKTE (2)	4	8
X	Intervista		8
XI	Vëzhgime		15
	<b>SHUMA</b>		

Shpallet tabela e pikëve totale për të gjithë aplikantët.  
P.sh.

Emri i aplikantit	Pikët totale
A	
B	
C	

Firmat e anëtarëve të komisionit





## SHTOJCA 3

## JETËSHKRIM

I. EMRI MBIEMRI

II. DATËLINDJA

III. TELEFONI

IV. ARSIMI

V. KUALIFIKIMI

VI. CERTIFIKATA

VII. PUNËSIMI

VIII. PROJEKTE

## UDHËZIME

## 1. ARSIMI

Diploma e shkollës së lartë ose diploma e shkollës së mesme profesionale teknike.

## 2. PUNËSIMI

Renditen, njëra pas tjetrës, të gjitha punësimet sipas rendit kronologjik, duke filluar nga më e fundit.

## 3. CERTIFIKATAT

Certifikatat për pjesëmarrje në trajnime për aspekte të biznesit, për aspekte të mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale, zhvillimin e

praktikave profesionale dhe të tjera që lidhen me detyrën e instruktorit të praktikave profesionale të një institucioni publik të AFP-së.

## 4. PRODUKTET PROFESIONALE

a) Për trajnimin e nxënësve në praktikat profesionale në institucionet ofruese të AFP-së.

b) Për çështje të tjera të sistemit të AFP-së.

c) Për aspekte të biznesit.

## 5. TË TJERA:

a) Për certifikatat paraqiten kopjet e tyre.

b) Për shkrimet paraqiten kopje të faqes së parë.

## SHTOJCA 2:

## TABELA E TË DHËNAVE PËR APLIKANTËT

Emri mbiemri \_\_\_\_\_

Aplikuesi shënon brenda kllapave krahas rubrikës përkatëse:

- “Po” ose “Jo”, kur kërkohet përgjigje e tillë.
- Numrin përkatës, kur kërkohet numri.

1	Certifikata ( )
2	Numri i krediteve të fituara ( )
3	Vlerësimi në provimin e kualifikimit: “Shkëlqyeshëm” ( ) “Shumë mirë” ( ) “Mirë” ( ) “Mjaftueshëm” ( ) “Dobët” ( )
II	SHKRIME
1	Shkrime për mësimdhënien (numri i tyre)
2	Shkrime për çështje të tjera arsimore (numri i tyre)
III	KUMTESA
1	Kumtesa në takime kombëtare për arsimin (numri i tyre)
IV	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TË MBROJTURA)
1	Microsoft Word ( )
2	Përdorimi i internetit ( )
3	Excel ( )
4	Power Point ( )
V	NOTAT
	Nota mesatare në shkollën e mesme, e rrumbullakosur në numër të plotë ( )
VI	PROJEKTE (numri i tyre)

Dëshmoj se i kam kuptuar udhëzimet për plotësimin e shtojcës 2 dhe pasojat nga plotësimi i pasaktë i saj.

Firma

Data



**SHTOJCA 3:**  
**UDHËZIM PËR KOMISIONIN E**  
**VLERËSIMIT**

**1. Pranimi ose mospranimi i një aplikimi**

a) Komisioni nuk pranon aplikimet në të cilat mungon kopja e noterizuar për kategorinë e kualifikimit si mësues, e diplomës (diplomave) të shkollës së mesme.

b) Komisioni pranon aplikimet për çdo mungesë tjetër, por shënon me zero pikët për mungesat përkatëse.

**2. Pikët e intervistës**

Mblidhen pikët e secilit anëtar, shuma pjesëtohet me numrin e anëtarëve të komisionit dhe rezultati rumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

**3. Pikët e vëzhgimit të orës (orëve) mësimore**

a) Kur vëzhgohet vetëm një orë mësimore, mblidhen pikët e secilit anëtar, shuma pjesëtohet

me numrin e anëtarëve të komisionit dhe rezultati rumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

b) Kur vëzhgohen dy orë mësimore, mblidhen të gjitha pikët e anëtarëve për të dyja vëzhgimet dhe shuma pjesëtohet me numrin total të anëtarëve që kanë vëzhguar.

c) Rezultati rumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

**4. Pikët e një aplikanti**

a) Për të plotësuar pikët e një aplikanti, komisioni bazohet te shtojca 2 e tij.

**b) Rubrikat janë dy llojesh:**

Lloji i parë. Pikët e shtyllës “T” vendosen drejtpërdrejt te shtylla përkatëse e aplikantit, si gjuha angleze, notat mesatare, e disa të tjera. Këto janë për përgjigjet “Po”.

Lloji i dytë. Pikët e shtyllës “T” shumëzohen me numrin përkatës te shtojca 2 e aplikantit.

TABELA E PIKËVE TË NJË APLIKANTI

I		T	Aplikanti
1	Certifikata (2)	5	10
2	Numri i krediteve të fituara (3)	10	30
3	Vlerësimi në provimin e kualifikimit: “Shkëlqyeshëm” (Jo) “Shumë mirë” (Po) “Mirë” (Jo) “Mjaftueshëm” (Jo) “Dobët” (Jo)	10 8 6 2 0	8
II	SHKRIME		
1	Shkrime për mësimdhënien (2)	5	10
2	Shkrime për çështje të tjera arsimore (0)	3	0
III	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TË MBROJTURA)		
1	Microsoft Word (Po)	3	3
2	Përdorimi i internetit (Po)	2	2
3	Excel (Jo)	2	0
4	Power Point (Po)	2	2
IV	NOTAT		
	Nota mesatare në shkollën e mesme, e rumbullakosur në numër të plotë		7
V	PROJEKTE (2)	4	8
1	Intervista		8
2	Vëzhgime		15
	<b>SHUMA</b>		

Shpallet tabela e pikëve totale për të gjithë aplikantët.

P.sh.

Emri i aplikantit	Pikët totale
A	
B	
C	

Firmat e anëtarëve të komisionit



## VENDIM

Nr. 53, datë 26.1.2015

**PËR SKEMËN E NDIHMËS  
SHTETËRORE NË VENDIMIN E  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 411,  
DATË 20.6.2014 “PËR  
BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT TË  
STADIUMIT “RUZHDI BIZHUTA”  
ELBASAN, DHE FINANCIMIN E  
PARKUT OLIMPIK TË TIRANËS”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e :

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtar
Dareka Dariu	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 26.1.2015, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, ka marrë në shqyrtim ex-post vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 20.6.2014 “Për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit “Ruzhdi Bizhuta” Elbasan, dhe financimin e parkut olimpiq të Tiranës”, të zbatuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

## I. Procedura

1. Në zbatim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, me shkresën nr. 6163, datë 21.8.2014, MZHETS i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), në cilësinë e dhënësit të ndihmës, të njoftojë skemën e ndihmës shtetërore të publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 102 “VKM nr. 411, datë 20.6.2014 “Për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit “Ruzhdi Bizhuta”, Elbasan, dhe financimin e “Parkut Olimpik të Tiranës”, si edhe të paraqesë çdo informacion shtesë për vlerësimin e kësaj skeme. Financimi publik i infrastrukturës së sportit, është pjesë e rregullave të kontrollit të ndihmës shtetërore<sup>1</sup> dhe për të realizuar përputhshmërinë me ligjin e ndihmës shtetërore, të dyja masat duhet të njoftoheshin pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore (KNSH).

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 6157/1, datë 15.10.2014, paraqiti informacionin e nevojshëm për vlerësimin e të dyja skemave të ndihmës shtetërore pranë Drejtorisë së Tregut Brendshëm.

## II. Përshkrimi i skemës së ndihmës shtetërore

## A. Stadiumi “Elbasan Arena”

3. Prefektura e Elbasanit me rreth 321 100 banorë gjithsej<sup>2</sup>, ka siguruar financimin për rinovimin dhe përmirësimin me fonde publike të stadiumit ekzistues të saj “Ruzhdi Bizhuta”, aktualisht “Elbasan Arena”<sup>3</sup>. Qëllimi i mbështetjes ishte transformimi i stadiumit shtetëror të ndërtuar në vitin 1967, nga një stadium i thjeshtë futbollit në një arenë multifunksionale sipas standardeve të UEFA-s.

4. Dhënësi i ndihmës (MAS) njofton se stadiumi i rikonstruktuar do të përdoret kryesisht për ndeshje futbollit, gara atletike etj. duke krijuar një imazh modern për qytetin e Elbasanit, nëpërmjet rikonstruksionit të fasadës dhe sheshit përpara stadiumit, e cila do të luajë dhe rolin e një hapësire të re publike për qytetin që mund të përdoret gjatë kohës kur nuk ka ndeshje. Kapaciteti i stadiumit në të cilin është parashikuar kryerja e aktiviteteve sportive dhe kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare, është 12 520 spektatorë.

5. Vlera totale e investimit në këtë projekt, referuar projekt-preventivit të hartuar nga studio arkitekturore është në vlerën 560 milionë lekë, nga të cilat 444 milionë lekë janë financuar me fonde nga buxheti i shtetit, dhe diferenca nga Federata Shqiptare e Futbollit.

## B. Parku Olimpik i Tiranës

6. Dhënësi i ndihmës njofton se financimi i projektit të Parkut Olimpik të Tiranës është parashikuar të bëhet në dy vite buxhetore, respektivisht 200 milionë lekë në vitin 2014 dhe diferenca e kontratës do të financohet në vitin 2015.

7. Agjencia Shtetërore e Sportit në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ka kërkuar krijimin e një parku olimpik të rrethuar nga një pistë për atletikë në ambientet e Klubit Sportiv Dinamo. Godina e Administratës së Sportit Shqiptar do të jetë pjesë e parkut olimpik së bashku me Komitetin Olimpik Shqiptar dhe federatat e

<sup>1</sup> Sport and State Aid—Reining in the Populist Gesture

<sup>2</sup> Burimi i INSTAT

<sup>3</sup> Me Vendim të Këshillit Bashkiak Elbasan datë 24.6.2014



sportit. Parku olimpik të përfshijë gjithashtu godinën “Minipallati i Sportit”, me një auditor 185 vende, 1 sallë trajnimesh, 1 sallë mbledhjesh për rreth 20 persona. Në brendësi të godinës do të realizohet një palestër moderne stërvitore me një sipërfaqe 420 m<sup>2</sup> për peshëngritje, si dhe një palestër për sporte luftarake (mundje, karate, judo etj.).

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

8. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, mbështetja me grante nga buxheti i shtetit përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet: a) aktivizohen burime shtetërore; b) jepet një avantazh ekonomik; dhe c) ndikim në konkurrencë.

9. Rinovimi i Stadiumit “Elbasan Arena” dhe i Parkut Olimpik të Tiranës është financuar me fonde nga buxheti i shtetit. Financimi i këtyre dy projekteve mund të përbëjë ndihmë shtetërore, nëse është selektive dhe jepet për kryerjen e një aktiviteti të caktuar ekonomik<sup>4</sup>. Veprimtaria ekonomike e vënies në përdorim të infrastrukturës së Stadiumit në Elbasan dhe palestrave moderne stërvitore të Parkut Olimpik të Tiranës do të përfitojnë burime shtetërore<sup>5</sup>.

10. Bashkia e Elbasanit, në cilësinë e pronarit të stadiumit “Elbasan Arena” dhe përgjegjësit për mirëmbajtjen e saj, si edhe Agjencia e Zhvillimit të Sportit në cilësinë e administratorit të palestrave stërvitore, në bazë të ligjit të sportit<sup>6</sup>, do të nënshkruajnë një kontratë përdorimi me: në rastin e bashkisë - me Federatën Shqiptare të Futbollit, dhe në rastin e parkut olimpik - me federata të ndryshme sportive.

*Ofrimi i një objekti sportiv publik, kundrejt pagesës, përbën një aktivitet ekonomik. Kostot e investimit të nevojshëm për kryerjen e këtij aktiviteti ekonomik nuk janë të mbuluara me të ardhurat e veprimtarisë në fjalë, por me burime shtetërore. Prandaj, këto dy aktivitete ekonomike përfitojnë një avantazh, i cili nuk do të ishte ofruar në një situatë normale të tregut.*

11. Në lidhje me një efekt të mundshëm në tregti dhe konkurrencë në tregun e brendshëm, shfrytëzimi i objekteve sportive do të kryhet nga organizatorë të veprimtarive sportive dhe ndërmarrjeve vendëse me objekte të ndryshme të veprimtarisë së tyre ekonomike, me një ndikim të vogël në konkurrencë<sup>7</sup>.

*Konkluzion mbi ekzistencën e ndihmës shtetërore*

12. Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, Komisioni i Ndihmës Shtetërore arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që i bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, përbën ndihmë shtetërore.

IV. Ligjshmëria e ndihmës

13. Dhënia e ndihmës është objekt i miratimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Për këtë arsye, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përmbushur detyrimin në përputhje me ligjin nr. 9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 20, pika 3, dhe nenin 13 “ndihma shtetërore që mund të lejohet”, duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nga ana e Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

V. Përputhshmëria me nenin 13 (3) të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar

14. Objektivi kryesor i ndihmës është:

*- rikonstruksioni i stadiumit “Elbasan Arena” për organizimin e ri të ambienteve të brendshme të godinës ekzistuese dhe zgjerimin e saj me pjesë të re, duke ofruar shërbimet e nevojshme për median në harmoni me kërkesat e parashtruara nga UEFA; si dhe*

*- ndërtimi i Parkut Olimpik të Tiranës, duke përfshirë një pistë për atletikë në ambientet e Klubit Sportiv Dinamo me tribunë për spektatorë, ndërtimin e godinës “Minipallati i Sportit”, si edhe palestrave moderne stërvitore.*

Komisioni konsideron se vlerësimi i përputhshmërisë së masës duhet të bazohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në nenin 13, pika 3 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2014 “Për ndihmën shtetërore”, i cili parashikon se ndihma mund të lejohet nëse “lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e

<sup>4</sup> State aid SA.37109 (2013/N) – Belgium Football stadiums in Flanders

<sup>5</sup> State aid SA. 35440 (2012/N) – Germany Multifunktionsarena der Stadt Jena

<sup>6</sup> Ligji nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, i ndryshuar, neni 30, pika 3

<sup>7</sup> SA. 31722 – Hungary Supporting the Hungarian sport sector via tax benefit scheme



marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.

15. Dhënësi i ndihmës raporton se masa ka për qëllim realizimin e dy investimeve madhore, me ndikim të konsiderueshëm jo vetëm në cilësinë e sportit shqiptar por edhe të komunitetit, veçanërisht në qytetet Elbasan dhe Tiranë. Institucionet ndërkombëtare të FIFA-s dhe UEFA-s, kanë përcaktuar si kusht domosdoshmërinë e ndërtimit të një stadiumi modern, që plotëson kushtet edhe standardet e kërkuara prej tyre. Rikonstruksioni konsiston në organizimin e ri të ambienteve të brendshme të godinës ekzistuese dhe zgjerimin e saj me pjesë të re, duke ofruar shërbimet e nevojshme për median.

16. Stadiumi “Elbasan Arena”, i pozicionuar në periferi të qytetit, krijon një imazh modern për qytetin e Elbasanit, nëpërmjet fasadës dhe sheshit përpara stadiumit, dhe luan rolin e një hapësire të re publike për qytetin. Ideja e projektit për sheshin është frymëzuar nga motivet tradicionale të qilimave shqiptarë të ndërthurura me forma elipsoidale në shesh dhe në fasada.

17. Për rrjedhim, masa e ndihmës shtetërore mbështet realizimin e dy projekteve madhore dhe me impakt të konsiderueshëm, jo vetëm në cilësinë e sportit shqiptar, por edhe në zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike në qytetet Elbasan dhe Tiranë.

#### VI. Konkluzione

18. Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se masa e ndihmës për rikonstruksionin e stadiumit “Elbasan Arena” dhe ndërtimin e Parkut Olimpik të Tiranës, lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike, si edhe zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike dhe për këtë arsye është në përputhje me nenin 13, pika 3 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 17, 20 (pika 3), 24, 25, 29, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

#### VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore për ndërtimin e stadiumit “Elbasan Arena” dhe Parkut Olimpik të Tiranës, të parashikuar në VKM nr. 411, datë 20.6.2014 “Për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit “Ruzhdi Bizhuta” Elbasan,

dhe financimin e Parkut Olimpik të Tiranës”, mbështetur në nenin 13, pika 3 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse skema mbështet realizimin e dy projekteve të rëndësishme dhe me ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e sportit shqiptar, si edhe lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike .

2. Aksesin në infrastrukturën e stadiumit “Elbasan Arena” dhe Parkun Olimpik të Tiranës duhet të jetë i hapur për disa përdorues, duke respektuar parimin e transparencës dhe mosdiskriminimit. Nëse objektet sportive do të përdoren nga disa organizatorë të veprimtarisë apo shfrytëzues të objektit sportiv, atëherë mënyra e pagesës për përdorimin e tyre duhet të bëhen publike.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Arben Ahmetaj

#### VENDIM

Nr. 54, datë 26.1.2015

#### PËR SKEMËN EKZISTUESE TË MBËSHTETJES ME GRANTE NGA BUXHETI I SHTETIT NË SEKTORIN E SPORTIT

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e :

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtar
Dareka Dariu	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 26.1.2015, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” të ndryshuar, ka marrë në shqyrtim skemën ekzistuese të ndihmës shtetërore, nëpërmjet mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e dhënësit të ndihmës.



## I. Procedura

1. Në zbatim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me shkresën nr. 6163, datë 21.8.2014, MZHETS i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e dhënësit të ndihmës, të njoftojë skemën ekzistuese të ndihmës shtetërore, të parashikuar në nenin 7 dhe 17 të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin” i ndryshuar. Shoqatat sportive që kanë për qëllim pjesëmarrjen në veprimtari sportive ose zhvillimin e tyre, përfitojnë çdo vit nga buxheti i shtetit financime në formën e grantit dhe burimeve të tjera. MZHETS vlerësoi se aktivizimi i burimeve shtetërore në formën e grantit, në favor të organizatave të sportit në kushtet kur ato kryejnë një aktivitet ekonomik, mund të përmbajë elemente të ndihmës shtetërore, dhe për të realizuar përputhshmërinë me ligjin e ndihmës shtetërore, skema duhet të njoftohej pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore (KNSH).

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 6157/1, datë 15.10.2014, paraqiti informacionin e nevojshëm për vlerësimin e skemës ekzistuese të ndihmës shtetërore.

## II. Përshkrimi i skemës së ndihmës shtetërore

## a) Objektivi

3. Objektivi kryesor i skemës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport.

## b) Baza ligjore

4. Baza ligjore e skemës është:

- ligji nr. 9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, i ndryshuar

- udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4, datë 11.3.2014 “Për mënyrën e përdorimit të fondit “Grant/transfertë korrente e brendshme” për Federatat Sportive dhe Komitetin Olimpik Shqiptar”.

## c) Buxheti dhe mënyra e financimit

5. Ndihma jepet çdo vit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në formën e grantit. Vlera totale e ndihmës për vitin 2014 është planifikuar 96,615,914 lekë.

## d) Përfituesit

6. Përfituesit e skemës janë federatat e ndryshme sportive që ofrojnë shërbime sportive për anëtarët e tyre dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar. Federatat shqiptare të sportit

janë organizata jofitimprurëse, të cilat kanë për qëllim të zhvillojnë, promovojnë, kontrollojnë dhe të rregullojnë aktivitetet sportive të shoqatave dhe klubeve, të cilat janë anëtarë të federatave të tyre, në përputhje me statutet e tyre.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

7. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, masa përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet: a) aktivizohen burime shtetërore; b) jepet një avantazh ekonomik; dhe c) ndikim në konkurrencë.

## a) Burime shtetërore

8. Skema aktivizon burime shtetërore si rezultat i miratimit dhe shpërndarjes çdo vit të grantit nga buxheti i shtetit.

## b) Ndërmarrja dhe avantazhi ekonomik

9. Sipas informacionit të paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, vetëm aktivitetet sportive të anëtarëve të federatave kombëtare të ndryshme të sportit kanë të drejtë të përfitojnë vlerën e grantit të akorduar nga buxheti i shtetit.

10. Referuar ligjit nr. 9376, datë 21.4.2014 “Për sportin”, të ndryshuar, neni 30, pika 3 përcakton se:

*“Marrëdhëniet ndërmjet pronarit ose administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të objektit sportin, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale”.*

Gjithashtu, neni 32 i ligjit për sportin, parashikon se :

*“Organizatorët e veprimtarive sportive janë pronarë të së drejtës së transmetimit të kësaj veprimtarie. Ata mund ta shesin këtë të drejtë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me konkurrim publik, në përputhje me rregullat e përcaktuara në statutet e tyre”.*

Për më tepër, neni 34 i ligjit për sportin parashikon se:

*“Organizatorët e veprimtarive sportive gëzojnë të drejtën të përdorin sipërfaqet e dukshme të mjedisive sportive, ku zhvillojnë veprimtarinë ose garën sportive, për reklamën e shoqërive të ndryshme tregtare, në bazë të marrëveshjeve kontraktuese me to”.*

11. Sa më sipër, federatat e ndryshme sportive dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar do të konsiderohen ndërmarrje, për sa kohë që kryejnë një aktivitet ekonomik, si p.sh. shitja e biletave për evente sportive, shitja e të drejtës së transmetimit radioteleviziv apo nënshkrimi i marrëveshjeve të sponsorizimit ose reklamës.



12. Skema i jep një avantazh ekonomik përfituesve në organizimin e aktiviteteve sportive, sipas statutit të organizatave sportive, si rrjedhim lehtëson gjendjen financiare të tyre. Dhënësi i ndihmës ka vendosur kriteret kryesore për përfitimin e fondeve buxhetore nga ana e federatave shqiptare të sportit. Skema është selektive, por nuk trajton në mënyrë të diferencuar organizatat sportive me njëra-tjetrën.

13. Referuar udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4, datë 11.3.2014 “Për mënyrën e përdorimit të fondit “Grant/transfertë korrente e brendshme” për Federatat Sportive dhe Komitetin Olimpik Shqiptar”, zërat e shpenzimeve që lejohen të përballohen nga fondi “Grant/transfertë korrente e brendshme” për federatat shqiptare sportive përfshijnë dy kategori: 1. shpenzimet për pagat e dy punonjësve të federatave dhe shpenzime të tjera operative për funksionimin e veprimtarisë së federatave, dhe 2. shpenzime të tjera operative që kryejnë federatat për mbështetjen e sportistëve.

14. Referuar rasteve të ndihmës shtetërore të miratuara nga Komisioni Evropian<sup>8</sup>, mbështetja me burime shtetërore për mbulimin e shpenzimeve të sportistëve profesionistë është objekt i rregullave të kontrollit të ndihmës shtetërore në shtetet anëtare të BE-së<sup>9</sup>. Ndërsa mbështetja me burime shtetërore e kostove të personelit dhe investimeve nga ana e federatave/klubeve sportive janë objekt i njoftimit dhe autorizimit të ndihmës shtetërore, në kushtet kur ato kryejnë një aktivitet ekonomik.

15. Si rrjedhim, financimi me grant nga buxheti i shtetit<sup>10</sup> për mbulimin e kostove të personelit dhe investimeve nga ana e federatave kombëtare të sportit dhe Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar është objekt i njoftimit dhe autorizimit të ndihmës shtetërore, në kushtet kur ato kryejnë një aktivitet ekonomik.

c) Ndikim në konkurrencë

16. Meqenëse konkurrenca mes federatave të ndryshme sportive në mënyrë të qartë është e shtrirë në nivel ndërkombëtar dhe shumë aktivitete

kanë një përhapje dhe interes në vendet e rajonit/Evropës, masa e ndihmës shtetërore mund të ketë pasojë në konkurrencën. Për këtë arsye, mbështetja me fonde publike duhet të jetë në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian.

*Konkluzion mbi ekzistencën e ndihmës shtetërore*

17. Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, komisioni arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që u bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, përbën ndihmë shtetërore.

IV. Ligjshmëria e ndihmës

18. Dhënia e ndihmës shtetërore ekzistuese është objekt i autorizimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Për këtë arsye, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përmbushur detyrimin në përputhje me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 8 “Ndihma “De minimis””, duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nga ana e Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8, 17, 20 (pika 3), 24, 25, 29, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të konsiderojë skemën ekzistuese në përputhje me kriteret e legjislacionit të ndihmës shtetërore.

2. Ministria e Arsimit dhe Sportit të raportojë brenda datës 31 mars të çdo viti mbi vlerën totale të mbështetjes me grant nga buxheti i shtetit për:

- federatat e ndryshme të sportit – financimin për mbulimin e kostove të personelit dhe investimeve;

- Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar – financimin për pjesën e kostos së mbuluar të personelit.

3. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Arben Ahmetaj

<sup>8</sup> N118/2000 Subventions publiques aux clubs sportifs professionnels, France. SA. 31722 – Hungary Supporting the Hungarian sport sector via tax benefit scheme

<sup>9</sup> Bashkimit Evropian

<sup>10</sup> Sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4, datë 11.3.2014



## VENDIM

Nr. 55, datë 23.2.2015

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE  
PËR KRIJIMIN E “ZONËS EKONOMIKE”  
ME STATUSIN “ZONË E LIRË” NË  
SPITALLË, DURRËS**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Arben Ahmetaj	kryetar
Mimoza Dhëmbi	anëtar
Dareka Dariu	anëtar
Ahmet Mançellari	anëtar
Anduena Dedja	anëtar.

Në mbledhjen e tij të datës 23.2.2015, shqyrtoi masën e sipërpërmendur, të njoftuar nga Drejtoria e Privatizimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe vendosi të konsiderojë ndihmën në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

## I. PROCEDURA

1. Me shkresën nr. 6993/7, datë 19.2.2015, Drejtoria e Privatizimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes njoftoi pranë Sektorit të Kontrollit të Ndhmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETIS) projektvendimin e Këshillit të Ministrave ““Për shpalljen “Zonë ekonomike” me statusin “Zonë e lirë” në Spitallë Durrës””.

## II. PËRSHKRIMI I MASËS

## a) Përshkrimi i projektit

2. Projekti i shpalljes së zonës së lirë synon të tërheqë investimet e huaja dhe vendëse, të cilat ndikojnë në arritjen e stadeve të reja të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.

3. Qëllimi i krijimit të zonës është ndërtimi i një parku logjistik multimodal, i cili do të merret me shërbimet hyrëse, e cila do të jetë në funksion të ngarkim shkarkimit të anijeve si shesh qëndrimi kontenierësh, përpunimi dhe magazinimi i produkteve, aktiviteteve tregtare, import-eksport, ripaketim i lëndëve të para aktivitete prodhuese përpunuese, agro-ushqimor, shërbime të ndryshme, ndërtimi dhe mirëmbajtje e infrastrukturës etj. në funksion të veprimtarisë portuale dhe prodhuese që do të kryhet në zonë.

4. Krijimi i kësaj zone ekonomike në Spitallë paraqet disa avantazhe gjeografike dhe ekonomike, të tilla si:

- pozicioni afër Portit të Durrësit;
- lehtësirat e transportit për në Itali dhe në shtetet e Adriatikut;
- kryerja e investimeve vendos terminalin e ri në nivel konkurrues me aktivitetet portuale të tregjeve rajonale;
- do të mundësohet hapja e një numri të konsiderueshëm të vendeve të punës, duke i dhënë prioritet punësimit të banorëve të kësaj zone.

5. Gjithashtu dhënia e statusit të zonës së lirë mundëson që nëpërmjet përjashtimit nga detyrimet fiskale, zona e lirë të bëhet konkurruese në treg, të jetë tërheqëse në zhvillimin e mëtejshëm të investimeve brenda portit dhe jashtë tij, duke ndikuar në hapjen e tregut ndërkombëtar të investimeve.

6. Është parashikuar që në këtë zonë të kryhet një investim prej 50,000,000 eurosh dhe do të punësojë rreth 150 punonjës, të cilët do të merren me aktivitetin e zonës ekonomike. Ky investim do të reduktojë koston logjistike në vend, do të rrisë efikasitetin në administrim e burimeve të brendshme dhe do të rrisë konkurrueshmërinë dhe marketueshmërinë e produkteve shqiptare në tregjet rajonale.

## b) Baza ligjore

7. Baza ligjore për hartimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave ““Për shpalljen “Zonë ekonomike” me statusin “Zonë e lirë” në Spitallë Durrës””, është ligji nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”.

c) Administrimi i skemës/autoriteti i dhënies së ndihmës

8. Skema do të zbatohet nga Drejtoria e Privatizimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETIS).

## ç) Shtrirja gjeografike e skemës

9. Skema shtrin zbatimin e saj në zonën ekonomike të identifikuar nga shoqëria FERRA & CO në Spitallë Durrës dhe përfshin një sipërfaqe prej 22 ha. Sipërfaqja është regjistruar pronë në pronësi të shoqërisë “FERRA & CO” në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, me numër pasurie 148/6 dhe 149/1 zona kadastrale 8517.

## d) Shtrirja sektoriale e skemës

10. Ndihma do të jepet për kryerjen e veprimtarisë në:

- veprimtari prodhuese, përpunimi dhe agro-përpunimi;





- veprimtari tregtare, import-eksport;
- shërbime dhe magazinim mallrash;
- veprimtari ndihmëse.

e) Përfituesit

11. Përfitues të skemës janë të gjitha ndërmarrjet (e vogla, të mesme dhe të mëdha), të cilat do të përdorin zonën e lirë ekonomike duke kryer investime fillestare në zonën e lirë ekonomike. Përfituesit do t'u përkasin sektorëve të lejuar në këtë skemë. Në bazë të nenit 1, pika 2 e VKM nr. 815, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”” skema nuk do të zbatohet për ndërmarrjet të cilat janë në vështirësi.

12. Dhënësi i ndihmës do të përcaktojë kushtet që duhet të plotësojnë ndërmarrjet/përdoruesit e zonës së lirë ekonomike që do të ushtrojnë veprimtarinë në zonën e lirë ekonomike, në veçanti ato që lidhen me: llojin e veprimtarisë që do të ushtrohet, kontributin në investime, punësim apo modernizim të veprimtarive ekonomike, afatet e fillimit të veprimtarisë prodhuese ose asaj të shërbimeve.

f) Mekanizimi i dhënies së ndihmës

13. Ndihma do të jepet për të gjithë përfituesit, me plotësimin e të gjitha kushteve të vendosura në aktmarrëveshjen paraprake e lidhur me zhvilluesin e zonës së lirë ekonomike, dhe të miratuar si përdorues i zonës së lirë ekonomike nga dhënësi i ndihmës (Drejtoria e Privatizimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes).

g) Forma e ndihmës

14. Ndihma do të jepet në formën e përjashtimeve nga detyrimet fiskale në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”.

h) Kohëzgjatja e skemës

15. Periudha e funksionimit të zonës ekonomike është 35 vjet. Të drejtën për përjashtimet nga detyrimet fiskale e kanë të gjithë përdoruesit e zonës së lirë ekonomike, të cilët kanë lidhur kontratë me zhvilluesin e zonës së lirë ekonomike me një afat deri në 35 vjet, por jo më shumë se afati i licencës së zhvilluesit.

i) Akumulimi

16. Në llogaritjen e intensitetit të ndihmës në kuadër të skemave apo në formën e ndihmave individuale nga zbatimi i kësaj skeme të ndihmës, do të merren parasysh të gjitha format e ndihmave

që ndërmarrjet/përdoruesit e zonës së lirë ekonomike kanë përfutuar apo mund të përfutojnë nga burime të tjera shtetërore.

### III. VLERËSIMI

#### 1. Ekzistenca e ndihmës shtetërore

17. Neni 4 i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, parashikon se: “Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

18. Në interpretim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, në skemën e shpalljes së zonës së lirë ekonomike, ndihma është e dhënë nga autoritetet publike (MZHEJT'S) dhe për këtë arsye konsiderohet se janë aktivizuar burime shtetërore. Sipas skemës së ndihmës së propozuar, avantazhi i përjashtimeve nga detyrimet fiskale jepet për përdoruesit e zonës ekonomike, të cilët kryejnë investime dhe krijojnë vende të reja pune në zonën e Spitallës në Durrës. Në funksion të faktit se skema përfshin sektorë dhe ndërmarrje aktive në tregti me shtetet e rajonit, ekziston mundësia e ndikimit të ndihmës në tregti.

19. Si rrjedhojë, në interpretim të nenit 4 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, skema e ndihmës shtetërore e njoftuar përbën ndihmë shtetërore.

#### 2. Ligjshmëria e ndihmës

20. Dhënia e ndihmës është objekt i miratimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Për këtë arsye, Drejtoria e Privatizimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka përmbushur detyrimin në përputhje me ligjin nr. 9374 datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, neni 13, shkronja “a” “ndihma shtetërore që mund të lejohet”, duke e njoftuar masën e ndihmës përpara vënies në zbatim të saj.

#### 3. Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

21. Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka shqyrtuar masën e ndihmës shtetërore të njoftuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale””. Nga vlerësimi rezulton se:



1. Ndhimja do të jepet për krijimin e vendeve të reja të punës dhe do të jetë e lidhur me një projekt për investim fillestar sipas VKM nr. 815, datë 28.12.2005<sup>11</sup>.

2. Intensiteti i ndihmës për investim do të shprehet në ekuivalentin neto të grantit (ENG).

3. Kërkesa për ndihmë nga ana e përfituesve/përdoruesve të zonës së lirë ekonomike do të dorëzohet te dhënësit e ndihmës përpara se të fillojë puna me projektet<sup>12</sup>.

4. Ndhimja do të jepet vetëm për të mbështetur investimin fillestar ose krijimin e vendeve të reja të punës të lidhura me këtë investim.

5. Ndhimja për investimin fillestar dhe ndihma për krijimin e vendeve të reja të punës do të kushtëzohet nëpërmjet mënyrës së pagesës dhe jepet vetëm nëse ruan investimin ose vendet e krijuara të punës për një periudhë prej të paktën 5 vjetësh.

6. Kontributi i përfituesit për financimin e investimit fillestar do të jetë të paktën 25%. Kontributi minimal nuk duhet të përmbajë dhe nuk duhet të mbështetet nga asnjë formë tjetër ndihme<sup>13</sup>.

7. Nuk do të jepet ndihmë për ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e qymyrit dhe hekurit.

8. Nuk do të jepet ndihmë për ndërmarrjet në vështirësi.

22. Për sa më lart, Komisioni i Ndhmës Shtetërore e konsideron skemën e ndihmës shtetërore të njoftuar në përputhje me nenin 13, shkronja “a” e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

#### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13, shkronja “a”, 17, shkronja “ç”, 22, pika 2, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

#### VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore për zbatimin e projektit “Për krijimin e “Zonës ekonomike” me statusin “Zonë e lirë” në Spitalë Durrës”, mbështetur në nenin 13, shkronja “a” e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse skema nxit

zhvillimin ekonomik të rajoneve të Republikës së Shqipërisë.

2. Drejtoria e Privatizimit në cilësinë e dhënësit të ndihmës në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për:

a) impaktin e investimeve dhe realizimin e të gjithë treguesve të tjerë gjatë vitit paraardhës financiar, të parashikuara në licencat përkatëse për të gjitha ndërmarrjet/përdoruesit e zonës së lirë ekonomike që përfitojnë ndihmë shtetërore nga dispozitat e ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”;

b) intensitetin e ndihmës, duke pasur parasysh që në llogaritjen e intensitetit të ndihmës në kuadër të kësaj skeme, të merren në konsideratë të gjitha format e ndihmave që ndërmarrjet/përdoruesit e zonës së lirë ekonomike kanë përfituar apo mund të përfitojnë nga burime të tjera shtetërore.

3. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

4. Drejtoria e Privatizimit në cilësinë e dhënësit të ndihmës në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes bazuar në nenin 20, pika 1 e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Arben Ahmetaj

#### KËRKESË

Shtetasja Luçie Ndoci, e bija e Mhillit dhe e Tones, banuese në lagjen “Fahri Ramadani” kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shpalljen të vdekur të shtetasit Ded Mhill Logu.

KËRKUESE  
Luçie Ndoci

#### KËRKESË

Shtetasja Eglantina Aliaj, e bija e Pëllumbit dhe e Manushaqes, e datëlindjes 22.7.1981, lindur në Fier dhe banuese në lagjen “Bylis”, Ballsh Mallakastër, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj shtetasit Eduart Aliaj.

KËRKUESE  
Luçie Ndoci

<sup>11</sup> Neni 6 i VKM nr. 815, datë 28.12.2005

<sup>12</sup> Neni 3 i VKM nr. 815, datë 28.12.2005

<sup>13</sup> Neni 4 i VKM nr. 815, datë 28.12.2005

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë